

**Në Gjykatën e Qarkut të Pejës**  
**Numri i Çështjes P. 87/11**  
**3 Qershor 2011**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Qarkut në Pejë, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Malcolm Simmons, Kryetar i Trupit Gjykues dhe gjyqtarët Gunnar Oyhaugen dhe Sali si anëtarë të Trupit Gjukes, si dhe me Procesmbajtësen Svetoslava Savova, në çështjen penale kundër Atdhe Bekaj (më tej "i pandehuri"), i akuzuar sipas Aktakuzës PPS numër 109/2010, të datës 25 Janar 2011 me Veprën penale të Vrasjes së Rëndë sipas Nenit 147 (9) të Kodit Penal të Kosovës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më 05, 06, 07, 13, Prill 15, 04, 24 Maj, 02 dhe 3 Qershor 2011, me çrast znj Merita Bina-Rugova përfaqësoi Prokurorinë, i dëmtuari nuk ishte i pranishëm dhe I pa përfaqësuar gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, por përpara përfundimit të procedurave të provave dhe më pastaj u përfaqësua për pak kohë nga Enver Nimani, kurse Haxhi Cekaj, Gafurr Elshani dhe Aziz Rexha prezantuan të pandehurin, me çrast i pandehuri ishte i pranishëm gjatë gjithë kohës, pas votimit dhe shqyrtimit, më 3 Qershor 2011, mori dhe publikisht shpalli si në vijim këtë

**AKTGJYKIM**

I pandehuri Atdhe Bekaj, i lindur më 24 Prill 1979 në Pejë, me banim në rrugën e TMK-së, i biri i Bajram dhe Rushe Bekaj, mbiemri i vajzërisë Ahmetaj, qytetar i Kosovës, me arsimim fillorë, pamartuar, me profesion punëtor, me gjendje financiare mesatare, pa qenë i dënuar më parë, në paraburgim prej 21 Tetorit 2011, është

**FAJTOR**

Sepse:

Më 31 Janar 2005 rreth orës 11:25 në rrugën kryesore Pejë-Deçan, në rrugën e TMK-së në Pejë, në afërsi të Hotel Parkut, duke përdorur një M Browning - 1911 armë dore e kalibrit 9 x 19 mm, me numër serik 200819, nga afërsia ka shtënë në personin Sadik

Musaj, i cili pësoi një plagë me armë zjarri në shpatullën e majtë dhe një plagë me armë zjarri në anën e majtë të barkut të tij me një plagë dalëse në anën e djathtë të parmë të pjesës së ulët të barkut të tij, si pasojë e të cilave, Sadik Musaj vdiq më 1 Shkurt 2005 në Kampin Bondsteel në Kosovë. Certifikata e vdekjes e regjistron shkakun e vdekjes si Shok hemorragjik të shkaktuar nga plagët me armë zjarri në bark dhe qafë.

Ishte një takim rasti në mes të pandehurit dhe Sadik Musaj më 31 Janar 2005, me ç'rast pasoi një grindje mes tyre. Edhe pse ishte Sadik Musaj në posedim të një pistoletë dhe një granatë dore në mënyrë të paligjshme, Gjykata konstaton se i pandehuri nuk po vepronte në vetëmbrojtje të nevojshme kur qëllloi Sadik Musën.

I pandehuri qëllloi të paktën katër plumba nga arma e tij. Dy nga ato plumba janë shkrepur nga distanca e afërt dhe goditi Sadik Musën. Dy plumba goditën objektin "Te Taka".

Në këtë mënyrë, i pandehuri ka kryer veprën penale të vrasjes nga Neni 146 të Kodit Penal të Kosovës.

Prandaj, në pajtim me dispozitat e Neneve, 6, 11, 15, 31, 32, 33, 34 pikat 1 dhe 2, 38, 64 par 1, 65 par 1, 73 par 1, 99 par 1, Neni 146 i KPK-së dhe Nenet 99 par 1, 2 pikat 3, 4, 6, par 3, 102 par. 1, 328 par 1, 385 par. 1 dhe 2, 386 par 2, 387 par 1 dhe 2, 391 dhe 392 të KPPK-së, i pandehuri

#### **DËNOHET**

Me burgim në kohëzgjatje prej PESËMBËDHJETË (15) vjetësh.

Në pajtim me Nenin 391 paragrafi (1), nën paragrafi (5) dhe Neni 278 paragrafi (7) të KPPK-së, koha që i pandehuri ka kaluar në paraburgim prej 21 Tetorit 2010 deri më 3 Qershor 2011 e tutje, do të llogaritet në dënim.

Në pajtim me Nenin 102 paragrafi (1) lidhur me Nenin 99 paragrafin (1) dhe (2), nën paragrafët (3), (4) dhe (6) të KPPK-së i pandehuri do të mbulojë shpenzimet e këtyre procedimeve penale në shumën prej 800 (tetëqind) Eurosh, si dhe shumën e planifikuar prej 100 (njëqind) Euro.

Pala e dëmtuar mund të bëjë kërkesë për kompensim përmes gjykatave civile.

## **ARSYETIMI**

### **A. Sfondi procedural**

#### **i. Aktakuza**

Është pohuar në Aktakuzë se më 31 Janar 2005 rreth 11:25, në Pejë, në afërsi të Hotelit Park, i pandehuri e ka privuar me qëllim nga jeta Sadik Musaj, motivi i aktit të paskrupullt ishte hakmarrja, sepse Sadik Musaj ishte dëshmitar kundër të ashtuquajturit "Grupi I Dukagjinit", ëështja penale P 190/02 në Gjykatën e Qarkut në Pejë, në lidhje me vdekjen e vëllait të tij, Sinan Musaj për vrasjen e të cilit daja i të pandehurit, , është shpallur fajtor së bashku me disa persona të tjerë. Në mënyrë të veçantë, është se ndërsa Sadik Musaj ishte duke ecur rrugës me , disa hapa prapa për shkak të hapësirës së vogël në trotuar, i pandehuri, i cili e kishte vënë re të ndjerin Sadik Musaj nga ana e kundërt e rrugës, iu afrua duke kaluar nga ana tjetër e rrugës dhe kur iu afrua viktimës, me anë të një revoleje "Broëning" M-1911, numri serik 200819, I kalibrit 9 mm, nga një distancë prej 10-15 cm shtiu mbi atë në pjesën e majtë të stomakut dhe pastaj përsëri në pjesën e majtë të gjoksit dhe kështu që ai preku xhaketën e tij me grykën e revoles. Viktima ra poshtë dhe një ditë më vonë ndërroi jetë në spitalin e kampit "Bondsteel" si pasojë e shokut hemorragjik të pësuar nga lëndimet nga të shtëna zjarri. I pandehuri arriti të ikë edhe pse dëshmitari qëlloi drejt tij disa herë.

Këtu, sipas prokurorit, i pandehuri ka kryer veprën penale të Vrasjes së Rëndë sipas Nenit 147 (9) të KPK-së.

Aktakuza u konfirmua më 01 Mars 2011.

#### **ii. Kompetenca e Gjykatës dhe përbërja e Trupit Gjykues**

Në përputhje me Nenin 23 (1) të KPPK-së, Gjykatat e Qarkut ka kompetencë për të gjykuar në shkallë të parë veprat penale të dënueshme me burgim prej së paku pesë vjet ose ato vepra të dënueshme me burgim afatgjatë.

Në rastin konkret i pandehuri u akuzua për vrasje të rëndë sipas

Nenit 147 (9) të Kodit Penal të Kosovës, vepër penale që dënohet me burgim prej së paku 10 vjet ose burgim afatgjatë.

Vepra penale, sipas Aktakuzës, është kryer në Pejë, e cila është në territorin e Qarkut të Pejës. Prandaj, në përputhje me Nenin 27 (1) të KPPK-së, Gjykata e Qarkut në Pejë ka juridiksion territorial për të gjykuar këtë rast.

Asnjë çështje nuk u ngrit nga palët në lidhje me juridiksionin e kësaj gjykate.

Për më tepër, në bazë të Nenit 3 të Ligjit mbi Kompetencat caktimin dhe përzgjedhjen e rasteve për gjyqtarë të EULEX-it dhe prokurorëve në Kosovë (më tej "Ligjit mbi Kompetencat"), Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurë penale kanë juridiksion dhe kompetencë për çdo lëndë të hetuar ose të ndjekur penalisht nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës.

Meqë çështje aktuale është hetuar dhe Aktakuza është ngritur nga Prokurori Special i Kosovës, Trupi Gjykues i Gjykatës së Qarkut të Pejës ishte në mënyrë të drejtë i përbërë nga një panel i përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor në përputhje me Nenin 4.7 të Ligjit mbi Kompetencat.

Asnjë çështje nuk u ngrit nga palët në lidhje me përbërjen e trupit gjykues.

## **B. Shqyrtimi kryesor**

### **i. Provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor**

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor në vijim u dëgjuan dëshmitarët dhe dëshmitë e mëposhtme janë administruar

#### *i.i Dëshmitarët*

B        Z

G        G

B        T

A        G

B        U

S B

M M

A D

I S

A B

I pandehuri

*i.ii Deklaratat e dëshmitarëve*

Deklaratat e , të datës 31 Janar 2005, 1 Shkurt 2005, 3 Shkurt 2005, 12 Shkurt 2005 dhe 8 Nëntor 2010.

Deklarata e , e datës 29 Dhjetor 2010.

Deklaratat e , të datës 31 Janar 2005, 1 Shkurt 2005 dhe 2 Shkurt 2005 dhe 11 Nëntor 2010.

Deklaratat e , të datës 31 Janar 2005 dhe 12 Nëntor 2010.

Deklaratat e , të datës 31 Janar 2005 dhe 15 Nëntor 2010.

Deklaratat e , të datës 31 Janar 2005 dhe 25 Nëntor 2010.

Deklaratat e , të datës 31 Janar 2005 dhe 18 Nëntor 2010.

Deklaratë e , e datës 7 Shkurt 2005

Deklaratë e , e datës 25 Shkurt 2005

Deklaratë e , e datës 26 Shkurt 2005

*iii. Dëshmi Dokumentuese*

Raporti nga vendi i krimit

Raporti i mjekësisë-ligjore dhe Plani gjeometrik i pozitës datës 31 Janar 2005

Fotografitë e pozitës gjeometrike

Raporti i autopsisë MA 05-020 të datës 2 Shkurt 2005

Raporti i ekzaminimit të rrobave që i kishte të veshur

Raporti i ekzaminimit të rrobave të veshura nga Sadik Musaj

Raporti i ekzaminimit të BMË, regjistrimi DK 24927

Raporti Balistik i datës 2 Maj 2005

Raporti Balistik i datës 6 Janar 2011

Të gjitha palët dhanë pëlqimin dhe rranë dakord për Raportin nga Vendi i Krimit, raportin e mjekësisë-ligjorë dhe Planit të pozicionimit gjeometrik, Fotografitë gjeometrike, raportin e autopsisë, Raportin e ekzaminimit të rrobave të veshura nga , Raportin e ekzaminimit të rrobave të veshura nga Sadik Musaj, Raportin e Ekzaminimit të BMË-së, numër i regjistrimit DK 24927, raportin balistik të datës 2 Maj 2005 dhe raportin balistik të datës 6 Janar 2011.

Certifikata e vdekjes së Sadik Musës të datës 1 Shkurt 2005 të lëshuar nga Camp Bondsteel në Kosovë

Aktgjykimi në Çështjen numër CC 190/02 të datës 17 Dhjetor 2002.

Raporti pa datë i zyrtarit të policisë, Halil Dreshaj, për dorëzimin e armëve të zjarrit në posedim të

Raporti i zyrtarit të policies, Halil Dreshaj, të datës 8 Shkurt 2005 mbi dorëzimin e armës së zjarrit të viktimës në posedim të

Raporti i zyrtarit të policies Vedat Rexhaj, të datës 31 Janar 2005, mbi dorëzimin e armës së zjarrit të viktimës në posedim të

**ii. Dëshmia e dëshmitarit para kësaj Gjykate**

Prokuroria propozoi të ftohet . Ai u shqyrtuar nga prokurori më 29 Dhjetor 2010. Ai ishte ftuar në mënyrë të rregullt të paraqitet para kësaj Gjykate, por nuk arriti ta bëjë këtë. Me marrëveshjen e palëve deklarata e tij u pranua në prova.

Në deklaratën e tij përmend dënimin në vitin 2002 të , i cili u dënua për rolin e tij në paraburgim të paligjshëm dhe vrasjen që pasoi të Sinan Musaj. Prokuroria vuri si provë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë numër i Çështjes CC 190/02 të datës 17 Dhjetor 2002.

Ishte e pakontestueshme fare që është daja i të pandehurit, kurse Sinan Musaj ishte vëllai i Sadik Musaj.

Në deklaratën e tij deklaroi se, gjatë gjykimit të të akuzuarve për vrasjen e paligjshme të Sinan Musaj, Sadik Musaj kërcënoi njërin nga të pandehurit duke thënë se ai do të marrë hak për vdekjen e vëllaut të tij duke deklaruar: "do ta ha kokën tuaj ". Nuk është e qartë në dukje të kësaj deklarate nëse ka qenë i pranishëm, kur dëgjoi këto fjalë të folura gjoja nga Sadik Musaj.

Mbrojtja e ftoi . Ai u intervistua nga policia më 7 Shkurt 2005. Ai dëshmoi në këtë Gjykatë më 13 Prill 2011.

Në deklaratën e tij të datës 7 Shkurt 2005 ai tha se është një floktar dhe pronar i lokalit "Te ". Ai e kishte njohur Sadik Musaj që nga viti 2000. Ai rregullisht ka prerë flokët e tij.

"Te " është në anën jug-perëndimore të rrugës. Ajo është në të njëjtën anë të rrugës, sikurse Hotel Parku.

Në deklaratën e tij ai i tha policisë se rreth orës 11:00 të ditës në fjalë, Sadik Musaj arriti në dyqanin e tij që të prejë flokët e tij. Ai ishte i shoqëruar nga një person që e njohte si " ". Gjykata konstaton se me emrin " " I referohet . Kur dëshmoi para kësaj Gjykate ai tha se nuk mund t'i kujtohej nëse ata arritën së bashku.

Në deklaratën e tij, përkthuan Sadik Musaj të ulur në karrigën më të largët nga dera. Kur dëshmoi para kësaj Gjykate, nuk i kujtohej saktësisht se ku ulej Sadik Musaj. Ai mendoi se mund të ketë qenë ulur në njërën nga dy ulëset në mes të rreshtit prej katër ulëseve

Në deklaratën e tij ai tha qëndronte në afërsi të derës. Ai tha se kjo ishte praktikë e tyre e "zakonshme". Kur dëshmoi para kësaj Gjykate, atij nuk mund t'i kujtohej në sa raste në të kaluarën Sadik Musaj e ka shoqëruar .

Prokuroria e ftoi . Ai u intervistua nga policia më 31 Janar 2005, 1 Shkurt 2005, 3 Shkurt 2005 dhe 12 Shkurt 2005 dhe u ekzaminua nga prokurori më 8 Nëntor 2010. Ai dëshmoi para kësaj Gjykate më 6 Prill 2011.

Ai i përshkroi marrëdhëniet e tij me Sadik Musaj si miq. Ai tha se takoheshin shpesh. Ai e mohoi ai ishte i ashtuquajtur "truproje" e Sadik Musaj edhe pse kështu në mënyrë të qartë mbrojtja si dhe dëshmia e la të kuptohej.

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate, ai tha se rreth orës 10:30 më 31 Janar 2005 u takua me Sadik Musaj në lokalin "Te ". Ai tha se Sadik Musaj ishte vetëm. Ata qëndruan aty rreth 15 minuta.

Duke iu referuar planit të bashkëngjitur raportit të mjekësisë ligjore të policisë (në tekstin e mëtejme "plani gjeometrik") përshkroi largimin nga lokali "Te " me Sadik Musaj dhe duke ecur drejt Urës së Gurit - në drejtim të qendrës së qytetit.

Kishte dëborë në shteg. Ata ecnin në rresht nga një, disa hapa para Sadik Musaj. Ai mendonte se ishte duke ecur këmbë rreth 5-6 deri në 10 metra përpara Sadik Musaj.

Ai e përshkroi të pandehurin duke ecur drejt tij. Atij nuk i kujtohet nëse i pandehuri kishte kaluar rrugën. Ata kaluan njëri-tjetrin. Ai tha se mendonte se dëgjoi Sadik Musaj duke i thënë diçka të pandehurit. Ai nuk dëgjoi se çfarë u tha. Ai tha se u kthye. Ai tha se pa Sadik Musaj di ra të pandehurit shuplakë në fytyrë. Ai e përshkroi të pandehurin duke e nxjerrë pistoletën. Ai tha se e nxorri armën e tij. Atij nuk i kujtohet nëse ai e nxorri armën e tij para se të shkrepë i pandehuri krismën e parë. Ai tha se kjo ka ndodhur shumë shpejt. Ai e përshkroi Sadik Musaj duke u përkulur dhe pastaj bie në tokë. Ai tha se nuk kishte parë armë në dorën e Sadik Musës. tha se ai qëlloi në ajër.

Në deklaratën e dhënë policisë më 31 Janar 2005, përshkroi se si ai dhe Sadik Musaj ecnin përgjatë rrugës. Ai tha

*"...[ i pandehuri] kaloi në anën e kundërt të rrugës. E njihja këtë person si figurë, por kurrë nuk kam folë me të ... Ai lëvizte dhe kaloi pranë meje, unë vazhdova pa asnjë dyshim, në atë moment e pashë ... [të pandehurin] e kapi Sadikun për xhaketën e tij dhe qëlloi në drejtim të tij, mendoj 2 ose 3 herë. Pastaj unë u ktheva shpejt dhe ai shtiu në mua ... "*

Kur u intervistua më 31 janar 2005 nuk e përmend që ka dëgjuar Sadik Musaj duke i thënë ndonjë gjë të pandehurit. Kjo ishte dëshmia e tij, ishte i akuzuari i cili e kapi Sadik Musën me rrëmbim. Ai nuk përmendi se Sadik Musaj i rra shuplakë të pandehurit. Në të vërtetë, në dukje të deklaratës së tij të më hershme, ai u kthye vetëm kur u dëgjua e shtëna.

Në deklaratën e tij policisë më 1 Shkurt 2005, ai e përshkroi të pandehurit duke e kaluar rrugën drejt tij. Ai tha se

*"Pasi kemi kaluar pranë njëri-tjetri, ai po ecte normalisht, ndërsa kur ishte duke e kaluar viktimën, e kam dëgjuar të shtënat me armë zjarri. Kur ktheva kokën, pashë se i pandehuri mbante armë, me të cilin shkrepiti dy ose tre plumba. Nuk më kujtohet. Në atë moment viktimja ka rënë për tokë, ndërsa i dyshuari vuri pistoletën në drejtimin tim dhe qëlloi dy ose tri herë. "*

Kur u intervistua më 1 Shkurt 2005 përsëri nuk e përmend të ketë dëgjuar Sadik Musaj se i thoshte ndonjë gjë të pandehurit. Përsëri, nuk e përmend se Sadik Musaj e ka sulmuar të pandehurin. Duket gjithashtu nga kjo deklaratë se ai u kthye vetëm kur dëgjoi të shtënat.

Në deklaratën e tij policisë, më 3 Shkurt 2005, ai e përshkroi të pandehurit duke kaluar rrugën drejt tij. Ai tha

*"Ai kaloi pranë meje dhe ishte prapa meje. E njoha fytyrën e tij. Pastaj u ktheva dhe në atë çast pashë [të pandehurin] krahu për krahu me Sadikun. Kam qenë rreth 3 metra larg tyre.*

*[I pandehuri] rrinte pak prapa Sadikut, në krahun e majtë të Sadikut, ishin direkt pranë njëri-tjetrit. [I pandehuri] ishte pak më shtatlartë se Sadiku. Trupi [i të pandehurit] ishte në drejtim të anës së pasme të majtë të Sadikut. E pashë dorën e djathtë [të pandehurin] e mbante një pistoletë në lartësi të shpatullës [së të pandehurit] dhe*

ishte e drejtuar pjesën e pasme të shpatullës së majtë të Sadikut. Tyta e pistoletës pothuajse prekte supet e Sadikut. Pistoleta mbahej në një kënd horizontal, të drejtuar pakës poshtë. E pashë një të shtënë nga pistoleta që mbante [i pandehuri]. Sadiku menjëherë iu afrua [të pandehurit] dhe ata ishin ballë përballë njëri-tjetrit: Sadiku dukej se u përkul, akoma duke u përballë me të pandehurin. E pashë [i pandehuri] me pistoletë ende në dorën e djathtë dhe ajo [pistoleta] tani ishte në lartësi të stomakut-të Sadikut. Pistoleta ishte në drejtim të Sadikut dhe e drejtuar nga ana e majtë e Sadikut. Dëgjova edhe një të shtënë. Sadiku ra në tokë me shikim në të pandehurin dhe Sadik dukej se rra me gjunjë duke e goditur tokë së pari. Gjersa Sadiku ishte duke e qëlluar [me të shtëna], unë nxora një pistoletë nga brezi tek rypi i pantallonave që kisha të veshur. Mendova jeta ime ishte në rrezik nga [i pandehuri] i cili posa qëlloi Sadikun. E pashë [i pandehuri] pastaj qëlloi në mua."

iu shtrua pyetja nëse Sadik Musaj ishte i armatosur. u përgjigj dhe tha

"Jo. I pashë të dy duart e Sadikut dhe ai nuk mbante pistoletë. Ai nuk mbante asgjë. "

Përsëri, ai nuk e përmend në deklaratën e tij të mëparshme se ka qenë dëshmitarë kur Sadik Musaj e sulmoi të pandehurin. Ai nuk përmendi se ka dëgjuar Sadik Musaj duke i thënë ndonjë gjë të pandehurit.

Kur u intervistua nga policia më 12 Shkurt 2005, deklaroi

"[I pandehuri] ... më kaloi pranë duke mos thënë asnjë fjalë. Pastaj kam dëgjuar të shtënën. Para se të shtënte në Sadikun ai [i pandehuri] nuk na e tha asnjë fjalë të vetme mua ose atij. Nuk kishte asnjë fjalosje, pa grindje, pa fyerje dhe pa asnjë fjalë të keqe. Asnjë bisedë fare. Për mua të shtënat kanë qenë një surprizë e plotë ".

Kur u shqyrtua nga prokurori më 8 Nëntor 2010, ai tha si në vijim

**Prokurori:** "Çfarë ndodhi me Sadikun kur [i pandehurit] iu afrua atij?"

: "Pasi iu afrua Sadikut, dëgjova një si zhurmë, sikur ta kishin pasë një fjalosje, kjo zgjati shumë shkurtër, vetëm 2-3 sekonda dhe pastaj kam dëgjuar të shtënë"

**Prokurori:** "Çfarë ke bërë në këto momente kritike?"

: "Kur dëgjova të shtënat, u kthye dhe pashë Sadiku të gjysëm-shtrirë"

**Prokurori:** "A kishte Sadiku diçka në duart e tij?"

: "Jo, nuk pashë asgjë".

**Prokurori:** "A tha ndonjë gjë?"

: "Jo, nuk e kam dëgjuar"

...

**Prokurori:** "Çfarë ishte distanca në mes Sadikut dhe qitësit"

: "distanca shumë e afërt ..."

Prokuroria e ftoi . Ai u intervistua nga policia më 31 Janar 2005, 1 Shkurt 2005 dhe 2 Shkurt 2005 dhe u shqyrtua nga prokurori më 11 Nëntor 2010. Ai dëshmoi para kësaj Gjykate më 6 Prill 2011.

përshkroi se si, më 31 Janar 2005, ai mori një telefonatë nga i pandehuri. I pandehuri i kërkoi atij për ta ndihmuar atë të nisë makinën e tij. Rreth orës 9:30, shkoi të takohet me të pandehurin në adresën e tij në shtëpi.

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate, ai tha se shkoi me makinën e tij, me të pandehurin për të vizituar vëllain e të pandehurit, i cili ishte në spital. Ata më pas u kthyen në makinën e të pandehurit që ishte parkuar në rrugën Pejë-Deçan. Është e pakontestueshme se makina e të pandehurit ishte e tipit BMË, me numrin e regjistrimit DK 24927. e konfirmoi se kur u kthyen në makinë, ajo ishte e parkuar në pozicionin të shënuar në planin gjeometrik të vendit (skicë).

Ata nuk mund të ndiznin makinën. Dukej se akumulatori ishte zbrazur. dëshmoi se i pandehuri shkoi për të marrë

kabllotë për ndezjen e makinës.                   tha se ai u ul në ulësen e shoferit të makinës së të pandehurit dhe e priste që të kthehet. Është e pakontestueshme se automjeti shikonte në drejtim të Jug-lindjes në anën jug-perëndimore të rrugës. Kur dëshmoi para kësaj Gjykate ai tha se kishte një pamje të qartë, të pa penguar të rrugës përpara.

përshkroi te pandehurin duke ecur drejt "dyqanit te automjeteve", në anën tjetër të rrugës. Dyqani është përshkruar qartë në veri-lindje të rrugës në planin e vendit gjeometrik, përballë farmacise Bardha.

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai tha se kishte parë të pandehurin duke u kthyer në automjet "më pak se dhjetë minuta" më vone. Kur ai dëshmoi para prokurorit me 11 nëntor 2010 ai tha "rreth 2 minuta". Kur ai u intervistua nga policia më 1 shkurt 2005 ai tha "jo më shumë se 5 minuta".

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai e përshkroi të pandehurin duke ecur drejt tij. Ai tha që dëgjoi dikë duke thirrur "ndal, ndal". Ai tha se nuk kishte parë kush bërtiste. Ai tha se pa Sadik Musajn duke ndjekur pas te pandehurin dhe pas tij. Ai e përshkroi Sadik Musajn që ta ketë kapur dhe mbajtur ashtu të pandehurin dhe duke e kthyer atë me fytyrë përballë tij. Ai tha se pa Sadik Musajn dhe                   te çojnë duart (e tyre) drejt rripave të tyre. Ai mendoi se ata po përpiqeshin të merrnin armët. Ai tha se nuk ka parë armë në dorën e Sadik Musajt . Ai nuk e di se kush qëlloi i pari.

Kur ai u intervistua nga policia më 31 janar 2005 ai e përshkroi atë që ndodhi menjëherë pas i pandehuri u largua për të shkuar në dyqan automjeteve.

"... Pas një kohe të shkurtër kam dëgjuar të shtënat dhe kane qenë tre ose katër të shtëna. Pastaj kam dale nga automjeti dhe vura re ... [te pandehurin] duke vrapuar drejt meje që mbante një pistoletë në dorën e tij ... Kur ai ishte afër meje më tha: "ik me vrap prej këtu) !". Ai vazhdoi te vraponte"

Sipas kësaj deklaratë,                   nuk e pa te pandehurin te kthehej deri sa ai dëgjoi të shtënat. Ai nuk i ka treguar policisë për ndonjë grindje ndërmjet të pandehurit dhe Sadik Musajt. Ai nuk tha që Sadik Musaj e kishte kapur të pandehurin. Ai nuk tha që Sadik Musaj kishte çuar dorën e tij drejt rripit te tij sikur të donte te merrte armën.

Në të vërtetë, kur ai ishte intervistuar nga policia më 01-02 shkurt 2005 ai tha se nuk ka parë asgjë. Ai nuk bëri asnjë referencë ndaj ndonje grindjeje të supozuar ndërmjet të pandehurit dhe Sadik Musajt. Në fakt, duket se ishin te shtënat që fillimisht i terhoqen vëmendjen atij

**Prokurori:** "Çfarë ka ndodhur pasi keni dëgjuar të shtënat"

: "...[ i pandehuri erdhi] duke vrapuar drejt meje ...  
Ai më tha: "Vrapo, mos qëndro këtu". Ai gjithashtu kishte nje arme ... "

Kur ai u intervistua nga prokurori me 11 nëntor 2010 tha:

**Prokurori:** "A e pe ... [te pandehurin] duke u larguar?"

: "Unë nuk e pashe atë kur ai u largua, por kur ai po kthehej unë dëgjova nje zhurmën; kam dëgjuar kur viktimat tha " Ndal "..."

Gjë që kundërshtoi provat që dha para kësaj Gjykate, kur ai tha se nuk e dinte se kush kishte bërë titur "ndal".

Megjithatë, në aspekte të tjera provat që dha më 11 nëntor 2010 ishin në përputhje me provat që ai dha para kësaj Gjykate.

**Prokurori:** "cila ishte rrjedha e ngjarjeve, çfarë ke parë?"

: "... Sadiku e kapi ... [te pandehurin] per krahu"

**Prokurori:** A pate ndonjë gjë në duart e Sadikut "?

: "Jo, unë nuk pashë asgjë në duart Sadikut, por pashë një revolver në duart e personit që e shoqëronte atë "

**Prokurori:** "Përveç fjalës "ndal" a keni dëgjuar ndonjë gjë tjetër?"

: "Jo, nuk kam dëgjuar asgjë tjetër"

...

**Prokurori:** "Në këtë moment që Sadiku e kapi ... [te pandehurin] për krahu, a ishte ... [i pandehuri] duke mbajtur ndonjë gjë?"

: "Unë pashë ... revolen e [te pandehurit] "

...

**Prokurori:** "A keni vëne re nëse personi i tretë ndërmori ndonjë gjë?"

: "Unë pashë revolen e tij, por unë nuk mund të them se kush qëlloi"

ka qenë konsekuent gjate gjithë dëshmisë se tij, kur ai deklaroi se në duart e Sadik Musajt nuk kishte parë armë.

Prokuroria thirri . Ai u intervistua nga policia më 31 janar 2005 dhe marre ne pyetje nga prokurori më 12 nëntor 2010. Ai dëshmoi para kësaj Gjykate më 7 prill 2011.

Në deklaratën e tij në polici më 31 janar 2005 tregoi se si në ditën në fjalë ai ishte në një makinë me dy kolegët e tij dhe . po e ngjiste makinën. Duke iu referuar planit gjeometrik përshkroi se si e ndali automjetin në anën jug-perëndimore të rrugës kryesore Pejë-Deçan në afërsi të dyqanit te kasapëve; si te përshkruar në plan.

Ndërsa ishte duke parkuar automjetin ai përshkroi te ketë dëgjuar një zhurmë. Ai tha se mendoi qe automjetin e tyre e kishte goditur diçka. Duke dale nga makina e pa Sadik Musajn te shtrirë ne një distancë të shkurtër nga pjesa e pasme e automjetit të tyre.

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai e përshkroi viktimën të shtrirë kokë-poshtë në rrugë. Ai tha se viktima u hoq nga rruga në të njëjtin pozicion kokë-poshtë. Viktima është mbajtur në atë pozicion dhe kështu e kane vendosur në pjesën e prapme të automjetit të tyre. Ai përshkroi çfarë ndodhi më pas.

: kur ata e ngritën atë për ta vënë atë në automjetin tone DRC kam dëgjuar zhurmën e nje metali qe ra në tokë.

**Gafurr Elshani:** Çfarë ishte kjo?

: Unë mendoj se ishte një armë, ajo ishte me ngjyrë të zezë.

**Kryetari i trupit gjykues:** Ti e ke parë?

: Kur ata e ngritën atë, diçka ra dhe unë pashë këtë objekt qe ra në tokë dhe dëgjova tingullin.

...

: Kur ata e ngriten ate unë pashë diçka qe ra ne tokë nga pjesa e mesit te trupit të tij.

Kur ai u intervistua nga prokurori më 12 nëntor 2010 ai tha:

"... Diçka ra nga rrypi i viktimes"

Ai u pyet rreth kësaj, kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate

**Gjykatësi Gunnar Oyhaugen:** Kam vërejtur se në deklaratën tuaj para Prokurorit Publik ti ke thënë diçka ra në tokë nga rripi i viktimës.

: Që është beli.

**Gjykatësi Gunnar Oyhaugen:** E kuptoj, a keni mundur të shihni se kjo pistoletë, apo send metali, a ishte e ngjitur në rrip?

: E tëra që di është se nga pozita ku ai është ngritur lart sendi ka ra nga mesi i trupit.

Kur ai ka dëshmuar para kësaj Gjykate ishte i sigurt se arma ka rënë nga "mesi" i trupit të Sadik Musajt. Duke marr parasysh se viktima ishte ngritur nga toka akoma i përmbysur është e vështirë që ai të ketë parë armën në rripin e Sadik Musajt. Duket se kjo ishte thjesht supozim.

Prokuroria thirri . Ai ishte intervistuar nga policia me 31 Janar 2005 dhe ushte marrë në pyetje nga Prokurori me 15 Nëntor 2010. Ai dha deklaratë para kësaj Gjykate me 7 Prill 2011.

Në deklaratën e tij në polici me 31 Janar 2005 ka përshkruar se si në ditën në pyetje ai ak qenë në veturë me dy kolegë të tij dhe . Ai ka thënë se ka vozitur.

Ai ka përshkruar veturën në të cilën ishte duke u bartur të jetë parkuar në anën Jug-Perëndimore të rrugën përballë dyqanit të

kasapit. Ai ka thënë se kishte shumë borë porse rruga vet ishte e pastruar.

Në deklaratën e tij në polici me 31 Janar 2005 ai ka thënë se derisa vetura ishte duke u parkuar ai kishte dëgjuar një zhurmë që ai mendonte se ishte zhurmë fishekzjarrësh. Gjatë zbritjes nga vetura ai ka parë Sadik Musajn të shtrirë në rrugë prapa automjetit të tyre.

Ku ai dëshmoi ai përshkroi dy apo tre persona më pas duke ngritur Sadik Musaj nga toka dhe duke e bartur atë deri tek vetura e tyre.

Kur ai ishte intervistuar nga Prokurori në Nëntor 2010 ai përshkroi se si, derisa Sadik Musajn ishin duke e ngritur nga toka, dikush tha "i ra pistoleta". Ai e ka parë armën qartë sepse ka përshkruar atë të ketë qenë "ngjyrë e errët".

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai përshkroi se si, derisa viktimën ishin duke e ngritur nga toka, ai ka dëgjuar siç ai përshkruan kur "pesha" e armës ka goditur tokën. Ai ka thënë se e ka parë armën në tokë.

Dëshminë që ai ka dhënë para prokurorit me 15 Nëntor 2010 ishte, sa i përket tërë materialit, e njëjtë.

Prokuroria thirri . Ai ishte intervistuar nga policia me 31 Janar 2005 dhe është marrë në pyetje nga Prokurori me 25 Nëntor 2010. Ai ka dhënë dëshmi para kësaj Gjykate me 7 Prill 2011.

Në deklaratën e tij dhënë policisë me 31 Janar 2005 ka përshkruar se si në ditën në pyetje ai ishte duke vozitur një automjet dhe se ishte në shoqëri në atë automjet me kolegë dhe . Në atë deklaratë ai ka thënë se ka ndaluar automjetin përballë barnatores Te Taka.

Në deklaratën e tij dhënë me 31 Janar 2005 përshkruan të ketë dëgjuar tre apo katër të shtëna derisa ai ishte duke e parkuar automjetin. Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai tha se ka dëgjuar 1 apo 2 të shtëna.

Në deklaratën e tij të dhënë me 31 janar 2005 ai ka thënë se nuk ka menduar se tingëllima ishte e armës së zjarrit. Ai ka zbritur nga vetura dhe ka parë Sadik Musajn të shtrirë një distancë të shkurtër prapa automjetit të tyre. Ai ka ndihmuar personat tjerë për të futur Sadik Musajn në automjetin e tyre. Kur ai dëshmoi

para kësaj Gjykate ai përshkroi se si Sadik Musaj ishte i shtrirë përmbys në rrugë. Ai ishte bartur në mënyrë të njëjtë i përmbysur deri tek automjeti i tyre.

Në deklaratën e dhënë me 31 Janar 2005 ai ka thënë se derisa ishin duke e bartur në drejtim të automjetit të tyre ai ka parë që ai përshkruan si një pistoletë të zezë të bie nga trupi i Sadik Musajt.

Kur ai dëshmoi para prokurorit me 25 Nëntor 2010 ai është pyetur nëse e ka parë pistoletën të bie nga trupi i Sadik Musajt. Në përgjigjen e tij ai ka thënë

"Jo, por më vonë dëgjova se revolja e tij kishte ra poshtë. Unë nuk e kam parë atë revole..."

Megjithatë, çka është me rëndësi, ai dëshmon

"...unë i kam shpjeguar Prokurorit Publik tashmë se kur ne e kapëm nga këmbët dhe të tjerët nga shpatullat, duart e viktimës ishin varur të lëshuara dhe arma nuk ishte në të, përndryshe do ta kisha hetuar."

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai mohoi të ketë parë armën të bie në tokë.

Prokuroria thirri . Ai ishte intervistuar nga policia me 31 Janar 2005 dhe është marrë në pyetje nga Prokurori me 18 Nëntor 2010. Ai ka dhënë dëshmi para kësaj Gjykate me 7 Prill 2011.

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai mbante mend të ketë kaluar tre burra që dukej se ishin duke u fjalosur. Ata ishin duke sharë. Pasi kalon grupin ai dëgjon një grua të thotë fjalë në kuptimin që "ndaloni ata". Ai përshkroi të ketë dëgjuar një të shtënë me armë. Ai kthehet dhe sheh një nga burrat në tokë. Ai thotë se nuk ka parë armë. Dy burrat tjerë kishin ikur.

i ka dhënë deklaratë policisë me 31 janar 2005 vetëm disa orë pas incidentit. Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai konfirmoi nënshkrimi në deklaratën e tij ishte i tij. Deklarata përmbante një deklaram që i ishte lexuar atij. Duke marrë parasysh këtë kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate kujtesa e tij për ngjarjen ishte e dobët, Gjykata vendosi të pranoj si më shumë të besueshme versionin e ngjarjes siç është regjistruar në deklaratën e tij të dhënë në polici në ditën në pyetje.

Në deklaratën e tij në polici me 31 Janar 2005 përshkroi të ketë parë tre burra në dukje duke fole në rrugë afër Hotelit Park. Ai kalon tre burrat Ai pastaj dëgjon një të shtënë arme. Ai kthehet dhe sheh njërin nga burrat duke rënë në tokë. Personi i dytë mbante një armë. deklaroi

"...ky person me pistoletë shtiu në personin që ishte i shtrirë edhe tre herë"

Avokati Mbrojtës për të Pandehurin ngriti çështjen para Gjykatës lidhur me shtesën në faqen e dytë të versionit Shqip të deklaratës së Z. . Kjo shtesë përmbante, në mes tjerash, fjalët

"...personi i armatosur shtiu edhe tre herë në personin që ishte duke rënë"

Shtesa ishte shkruar në atë pjesë të faqes së dytë e cila ishte shënuar me vija kryqore. Qëllimi i shënimit të vijave kryqore në pjesën e papërdorur të faqes në të cilën është shkruar deklarata është që të pengohet bërja e shtesave të mëvonshme në deklaratë.

Berishës nuk i kujtohej nëse e ka bërë apo diktuar shtesën apo nëse me të vërtetë është bërë para nënshkrimit të deklaratës.

Nuk do të ishte e pazakontë të bëhet shtesë në fund të deklaratës. Do të ishte e parregullt të bëhet një shtesë e tillë në atë pjesë të çfarëdo deklarate që është shënuar me vija kryqore. Do të ishte e preferuar që të bëhej deklaratë shtojcë.

Megjithatë, shtesa nuk ka qenë krejtësisht e dëmshme ndaj të Pandehurit. Në deklaratë, duke iu referuar të Pandehurit, deklaroi "...ky personi me pistoletë shtiu në personin që ishte i shtrirë, edhe tre herë". Ishte dëshmia e tij, viktimia ishte i shtrirë në tokë kur ai është qëlluar "edhe tre herë". Kjo është cilësuar në shtesë ku është deklaruar se viktimia ishte qëlluar edhe tre herë derisa ishte "duke rënë poshtë". Qartë do të ishte më e dëmshme për të Pandehurin nëse ai do të qëllonte Sadik Musajn derisa ishte "i shtrirë" në tokë në krahasim me kur ai ishte "duke rënë" në tokë.

Në deklaratën e tij në polici me 31 Janar 2005 përshkroi si, derisa Sadik Musaj ishte duke u vënë në automjet, një armë ra nga trupi i tij.

ishte marrë në pyetje nga Prokurori me 18 Nëntor 2010. konfirmoi se ka nënshkruar procesverbalin e intervistës. Ai

procesverbal po ashtu përmbante deklaratën se procesverbali i ishte lexuar atij, se e ka kuptuar atë dhe se e ka nënshkruar pa ndonjë vërejtje.

Kur është marrë në pyetje nga prokurori ai përshkroi të ketë kaluar tre burra në rrugë. Pavarësisht që dëgjon një nga burrat të thotë "kush karin je ti" dukej sikur ai ka menduar se ata ishin shokë të mirë.

Ai përshkroi të ketë dëgjuar të shtënat dhe është kthyer të shikoj viktimën të shtrirë në rrugë. Duket nga ajo intervistë se ai nuk e ka parë të Pandehurin të qëllon Sadik Musajn.

thotë se derisa ishin duke ngritur Sadik Musajn nga toka dhe duke e vënë në automjet një armë ka rënë në tokë nga Sadik Musaj. Ai ka thënë se ka menduar se arma ka qenë në bel të Sadik Musajt. Qartë ky ishte një supozim. Ai merr armën dhe më vonë e dorëzon në polici.

Mbrojtja thirri . Ai më herët nuk kishte dhënë deklaratë në polici apo prokurori lidhur me faktet në pyetje. Ai dëshmoi para kësaj Gjykate me 13 Prill 2011.

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai përshkroi se në ditën në çështje ai ishte duke ecur përgjatë rrugës Pejë-Deçan në drejtim të Pejës. Ai tha se ka parë dy njerëz "duke u rrahur". Ai tha distanca nga ata ishte rreth gjatësisë së sallës së gjyqit. Gjykata gjen se gjatësia e sallës së gjyqit është 10 deri 12 metra. Ai tha se personi i tretë filloi të shtien nga një armë. Ai tha se nuk ka parë asnjërin nga dy burrat tjerë të mbanin armë. Ai tha se ka dëgjuar të shtëna por nuk ka parë se kush ka shtënë. Më vonë ka parë gjak në tokë por asgjë tjetër.

Mbrojtja thirri . Ai më herët nuk kishte dhënë deklaratë në polici apo prokurori lidhur me faktet në çështje. Ai dëshmoi para kësaj gjykate me 13 Prill 2011.

Ai përshkroi si, në ditën në çështje, ishte duke ecur në rrugën Pejë-Deçan në drejtim të Deçanit. Ai tha se ka parë para tij një burrë të vetëm duke ecur në drejtim të njëjtë. Gjykata gjen se ky ishte i Pandehuri. Ai tha se ka parë dy burra duke ecur në drejtim të të Pandehurit. I pari nga dy burrat ishte më i gjatë se i dyti. Gjykata gjen se i pari nga këta burra ishte derisa i dyti ishte Sadik Musaj. ishte përafërsisht 20-30 metra nga ta.

përshkroi të Pandehurin duke ecur pranë t pas së cilës Sadik Musaj kap të Pandehurin për rroba të tij. Ai përshkruan n duke shtënë nga një armë. Ai tha se ishte i pari që qëlloi. Ai tha se i Pandehuri dhe Sadik Musaj po ashtu kishin armë. Ai dëgjoi të shtëna por nuk kishte parë cili nga ta kishte qëlluar.

Mbrojtja thirri . Ai ishte intervistuar nga policia me 25 Shkurt 2005.

Në atë ditë në fjalë ai ishte me vëllezërit dhe në spital në Pejë. operohej në atë mëngjes.

Në deklaratën e tij të 25 Shkurtit 2005 ai ka thënë se qëllimi i tij ishte të udhëtoj në spital në automjetin e tij BMW. Megjithatë, automjeti nuk ndizej. Nuk ka dyshim se ky ishte automjeti lidhur me të cilin kishte dëshmuar . Ai përshkroi të Pandehurin duke arritur në spital rreth orës 11 paradite. I Pandehuri mori çelësat e BMW-së së përmendur. Pastaj u largua. Kjo provë nuk është kontestuar nga Prokuroria.

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai tha se më vonë kishte dëgjuar një bisedë lidhur me të shtënat me armë. Ai tha se kishte dëgjuar të përmendej emri "Atdhe". Ai nuk kishte asnjë arsye të di në atë fazë se ai ishte vëllai i tij. Tha se ka shkuar te vendi i ngjarjes.

Në deklaratë dhënë policisë ai thotë

"...ne dëgjuam nga disa kalimtarë se Sadik Musaj ishte vrarë nga një person i quajtur Atdhe. Kështu që ne ishim kureshtar të dimë nëse ishte vëllai ynë Atdheu."

Ai tha se nuk kishte dijeni të ketë pasur ndonjë problem në mes të pandehurit dhe Sadik Musajt.

Mbrojtja propozoi të thirret . Ai ishte intervistuar nga policia me 26 Shkurt 2005. Dëshmia e tij është pranuar nga palët. Ai ka thënë se i Pandehuri ka arritur në spital në mes orës 10.30 dhe 11 paradite.

Sa i përket të tërë materialit dëshmia e tij ishte e njëjtë sikurse e .

Në deklaratë të dhënë në polici në Shkurt 2005 ai iu referua asaj se kishte dëgjuar bisedën gjatë se cilës ai kishte zbuluar

se Sadik Musaj ishte qëlluar nga dikush me emrin "Atdhe". Ai thotë

"Kur unë dëgjova këtë unë u brengosa për vëllain tim"

**I PANDEHURI** dëshmoi para kësaj Gjykate më 15 prill 2011. Ai më parë kishte refuzuar që tu përgjigjej pyetjeve të policisë në lidhje me incidentin. Kjo ishte e drejta e tij.

Nuk ka dyshim që në kohën e arrestimit të të pandehurit ai kishte në posedim një armë dore të tipit Browning M - 1911 e kalibrit 9 x 19mm me numër serik 200819. Nuk ka dyshim që ishte arma e përdorur për të gjuajtur Sadik Musajn. I pandehuri tha se e mbante armën për të mbrojtur pronën e tij personale. Ai tha se objektet e tij të biznesit janë thyer dy herë. Ai mohoi se arma ishte për mbrojtje personale.

Ai tha se në ditën në fjalë, ai dhe po përpiqeshin të ndiznin automjetin BMW me numër të regjistrimit DK 24927. Nuk ka dyshim në lidhje me vendndodhjen e asaj veture që ishte paraqitur në mënyrë të qartë në planin e vendit.

I pandehuri përshkroi, duke iu referuar këtij plani, se kishte kaluar rrugën në këmbë drejt "dyqanit të automjeteve", që është përshkruar në plan. Ndërsa ai e bëri këtë, një njeri u përplas me të. Ai tha "mjaft fuqishëm". Ai tha se u kthye për të parë se kush ishte përplasur me të. Ndërsa e bëri këtë ai u kap nga një njeri tjetër, më i shkurt. Njeriu më i shkurtër që e kapi atë tha: "ndal", "Jeta jote ka mbaruar. Unë do ta qij nënën tënde." Ai pastaj e grushtoi të pandehurin në anën e majtë të fytyrës së tij. Nuk ka dyshim që njeriu më i shkurtër ishte Sadik Musaj, ose se njeriu që supozohet të jetë përplasur me të ishte .

I pandehuri tha se nuk e njohte asnjërin. Ai tha se kurrë nuk e kishte takuar apo parë Sadik Musajn.

I pandehuri tha se gjatë grindjes me Sadik Musajn dëgjoi një të shtënë. Ai tha se ishte rreth tre metra larg tij. Ai e përshkroi çfarë ndodhi pas kësaj

"Kur arma shkrep, personi që ishte duke u grindur me mua vuri duart në armë dhe nxori armën pastaj unë ia kapa dorën pastaj u sollëm pak përreth, sepse përpiqej të ma drejtonte armën në stomak."

I pandehuri demonstroi se si, duke përdorur dorën e majtë të tij Sadik Musaj kapi krahun e djathtë të të pandehurit. Ai tha se

dëgjoi një të shtënë të dytë. Ai tha se e shtëna nuk ishte e Sadik Musës. Pas dëgjimit të shtënës së dytë ai tha

"...duke pasur parasysh personin tjetër me armë në dorë kuptova se nuk kisha ku të shkoja u përpoqa të largohem nga ai, por ai nuk më linte të largohesha duke përdorur dorën për më të mbajtur dhe pastaj nxora armën time."

Kjo ishte dëshmia e tij që nxori armën, pas dëgjimit të shtënës së dytë.

Megjithatë, tutje gjatë dëshmisë së tij u zhvillua siç vijon

**I pandehuri:** ... ai po më mbante për krahu unë e nxora armën dhe e mbajta përpjetë me njërin dorë.

**Kryetari i trupit gjykues:** Ju ishit ende përballë njëri-tjetrit në këtë fazë?

**I pandehuri:** Po

**Kryetari i trupit gjykues:** Çfarë ndodhi më pas?

**I pandehurit:** Në atë moment dëgjova të shtënën e dytë..."

Është e qartë se më vonë i pandehuri dëshmoi se nxori armën e tij para dëgjimit të shtënës së dytë.

I pandehuri tha se gjuajti me armën e tij në drejtim të Sadik Musajt. Ai nuk e di se sa të shtëna kishte shkrepur. Ai tha se kishte dëgjuar të shtëna të tjera.

I pandehuri u pyet nëse e pa Sadik Musajn të bjerë për tokë. Në përgjigje ai tha

"Unë po ju them se nuk isha në kontroll nuk e di se çka ka ndodhur më zuri paniku unë nuk e dija se çfarë po ndodhte, e di që kur u largova nga vendi unë po mundohesha të largohesha shpejt sepse ai tjetri kishte armë po ashtu."

### C. Vlerësimi i provave

Gjykata dëgjoi dëshminë e  
dhe të  
pandehurit. Deklaratat paraprake të dëshmitarëve të  
lartpërmendur janë vënë në prova. Deklaratat paraprake të  
dhe janë pranuar dhe vënë në provë.

Gjykata shqyrtoi dhe vlerësoi Raportin e vendit të krimit, raportin mjeko-ligjor dhe Planin e vendit të datës 31 janar 2005, Fotografitë e vendit, raportin e autopsisë MA 05-020 të datës 2 shkurt 2005, Raportin e ekzaminimit të rrobave të , Raportin e ekzaminimit të rrobave të Sadik Musajt, Raportin e Ekzaminimit të BMW me regjistrim DK 24927, Raportin e balistikës të datës 2 maj 2005, Raportin e balistikës të datës 6 janar 2011, Vendimin për rastin me numër 190/02 të datës 17 dhjetor 2002, Raportin e oficerit të policisë Halil Dreshaj pa datë, Raportin e oficerit të policisë Halil Dreshaj të datës 8 shkurt 2005, Raportin e oficerit të policisë Vedat Rexhaj të datës 31 janar 2005, certifikatën e vdekjes së Sadik Musës me datë 1 shkurt 2005 e lëshuar nga Kampi Bondsteel në Kosovë.

#### **i. Të gjeturat nga faktet**

Nuk ka dyshim që më 31 janar 2005 mbi Rrugën e TMK-së, rruga kryesore Pejë-Deçan pranë Hotelit Park në Pejë, Sadik Musaj u qëllua nga i pandehuri. Rasti sipas të pandehurit ishte se ai ka vepruar në vetëmbrojtje të domosdoshme.

Prokuroria pranoi se takimi në mes të pandehurit dhe Sadik Musaj në ditën në fjalë ishte rastësi e thjeshtë.

I pandehuri u arrestua më 21 Tetor 2010.

Nuk ka dyshim që në kohën e arrestimit të të pandehurit ai kishte në posedim një armë dore të tipit Browning M - 1911 e kalibrit 9 x 19mm me numër serik 200819. Nuk ka dyshim që ishte arma të cilën i pandehuri ka përdorur për të qëlluar Sadik Musajn.

Nuk ka dyshim që 5 gëzhoja të fishekëve janë gjetur në vendngjarje. Katër nga gëzhojat janë 9mm. I pesti ishte 7.62mm. Vendet ku secila nga gëzhojat është gjetur është shënuar në planin e vendit me numra respektivisht prej 1 deri 5. Përveç kësaj një vrimë plumbi u gjet në dritaren e lokalit 'Te Taka'.

Gjykata konstaton se gëzhojat e gjetura nga skena dhe për të cilat është bërë referencë në planin e vendit si numrat 1, 2, 3 dhe 4 janë shkrepur nga arma e të pandehurit.

Gjykata konstaton se gëzhojat e gjetura në lokalitetin Te Taka, dhe të shënuar në planin e vendit si 6 dhe 7, u janë shkrepur nga arma e të pandehurit.

Gjykata konstaton se Sadik Musaj posedonte në mënyrë të paligjshme një armë dore të tipit Sig Sauer P228 e kalibrit 9 x 19mm me numër serik B234205. Raporti i Balistikës i datës 2 maj 2005 nxjerr në përfundim se asnjë nga gëzhojat e gjetura në vendin e ngjarjes nuk janë shkrepur nga kjo armë.

Nuk ka dëshmi të dhënë para Gjykatës se është gjuajtur kohëve të fundit me armën e gjetur në posedim të Sadik Musaj.

Gjykata konstaton se në kohën relevante Sadik Musaj ishte në posedim të paligjshëm të një granate dore.

Gjykata konstaton se në ditën dhe në kohën në fjalë ishte në posedim të paligjshëm të një arme dore e tipit Crvena Zastava- 57 e kalibrit 7.62 x 25mm me numër serik 105532. Raporti i Balistikës i datës 2 maj 2005 nxjerr në përfundim se rasti i gëzhojës së gjetur në vendngjarje e cila është e referuar në planin e vendit me numër 5 u shkrep nga kjo armë zjarri.

Autopsia e Sadik Musajt zbuloi tre plagë me armë. E para ishte një plagë e futur në anën e krahut të majtë. E dyta ishte një plagë e futur në anën e majtë të abdomenit. Plaga e tretë është konstatuar të ketë qenë me dalje jashtë. Asnjë nga fotografit e bashkëngjitura në raport përshkruan plagën me numër "3". Sidoqoftë, sqarimet janë dhënë në raportin e ekzaminimit mjekoligjor të rrobave të Sadik Musajt referuar më poshtë.

Shkaku i vdekjes është regjistruar në raportin e autopsisë si "gjuajtje me armë në bagazh". Certifikata e vdekjes tregon se shkaku i vdekjes është nga Shoku Hemorragjik i shkaktuar nga plagët e marra në abdomen dhe qafë nga gjuajtja me armë.

Rrobat e veshura nga Sadik Musaj në ditën e ngjarjes ishin subjekt i ekzaminimit mjekoligjor. Ekzaminimi zbuloi tri vrime të plumbit. Dy nga ato vrime janë zbuluar të jenë vrime hyrëse kurse e treta ishte vrimë dalje.

Një vrimë hyrëse ishte në anën e përparme të majtë të xhaketës. Perimetri i gjuajtjes përafërsisht ishte 10 - 50 cm.

Vrima e dytë ishte një vrimë dalëse dhe ishte në anën e djathtë të xhaketës. Vrima ishte krijuar nga plumbi i cili kishte kaluar përmes pjesës së poshtme të barkut të Sadik Musajt, pothuajse në një vijë të drejtë.

Vrima e tretë ishte në anën e djathtë të sipërme të supit - pjesa e qafës. Perimetri i gjuajtjes përafërsisht ishte 0. Ishte përcaktuar se tyta e armës së zjarrit ishte në kontakt (prekje) me xhaketën.

Vrimat e plumbave në xhaketën e veshur nga Sadik Musaj janë në përputhshmëri me rezultatet e ekzaminimit mjeko-ligjor.

Gjithashtu, dëshmitë në lidhje me rrobat e veshura nga Sadik Musaj është në përputhshmëri me atë se ishte i qëlluar nga një distancë e afërt.

Një ekzaminim i pjesës së jashtme të palltos që e kishte veshur ka zbuluar se ishte një vrimë depërtuese në dorën e majtë - përpara, me diametër prej disa milimetra. Shqyerja e palltos tregon se vrima në pjesën e jashtme të palltos ishte një vrimë dalëse. Mbetjet e armës së zjarrit ishin gjetur në anën e brendshme të palltos. Përfundimi i ekspertit i cili e ka kryer ekzaminimin ishte se vrima e shkaktuar ishte vrime e plumbit dhe se mbajtësi ka shkrepur armën nga brendësia e palltos.

Prokuroria në dëshmi ka vënë vendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë me numër CC 190/02 të datës 17 dhjetor 2002. Një nga të pandehurit në këtë rast ishte . Ai ishte dënuar për pjesën e tij në paraburgim të paligjshëm dhe vdekjen e mëpasshme në vitin 1999, mes të tjerash edhe të Sinan Musajt.

Nuk vihet në dyshim se ishte daja i të pandehurit dhe se Sinan Musaj ishte vëllai i Sadik Musajt.

ishte marrë në pyetje nga prokurori më 29 dhjetor 2010. Duke iu referuar gjykimit të këtyre të akuzuarve për vrasje të paligjshme të Sinan Musajt, ishte dëshmia e t se Sadik Musaj i ka kërcënuar të pandehurit duke i thënë se do të merr hakun për vdekjen e vëllezërve e tij dhe ka thënë "Do të jua ha kokat". Palët janë pajtuar që deklaratë e tij të përfshihet në dëshmi.

ka dhënë një dëshmi se për afërsisht në ora 11 në ditën e ngjarjes, Sadik Musaj ka ardhur në shitoren e tij për t'i prerë flokët. Ai ishte klient i rregullt prej thuhet vitit 2000. Ai ishte i shoqëruar nga . ka qëndruar afër derës. Dukej se kjo ishte praktikë e zakonshme e tyre.

Ishte rasti i të pandehurit se në ditë në fjalë ai ishte duke ecur në rrugën e TMK-së. Ai ka përshkruar se deri sa ecte përgjatë rrugës, ishte përplasur mbi të "mjaftë fort". Ai ka thënë se ishte kthyer të shikoj se kush është përplasur në të pastaj ishte rrëmbyer nga Sadik Musaj. Ai pastaj ka përshkruar zënkën që kishte pasuar dhe Sadik Musaj duke nxjerrë armën dhe ka provuar të shtijë në barkun e tij. Ai ka thënë se ka qëlluar i pari. Pastaj ai ka thënë se Sadik Musaj ka shtënë. Ai ka thënë se ai nuk e ka njohur as atë njeri. Ky shpjegim i ngjarjes është në kundërtënie me dëshminë e dëshmitarëve tjerë.

Ishte rasti i mbrojtës që ishte ashtu quajtur si roje personale e Sadik Musajt. Kjo mund të jetë e vërtetë.

Dëshminë që e kishte dhënë para gjykatës ka kundërshtuar dëshminë e tij të mëparshme në lidhje me disa materiale të rëndësishme. Kur ai ka dëshmuar, ai e ka përshkruar të pandehurin duke ecur prapa tij. Sadik Musajt ecte disa hapa prapa tij. Ai ka thënë se ka menduar se e ka dëgjuar Sadik Musajn të i thotë diçka të pandehurit. Ai nuk e ka dëgjuar se çfarë i ka thënë. Ai ka thënë se ai u kthye mbrapa. Ai ka thënë se e ka pa Sadik Musajn duke e qëlluar me shuplakë nëpër fytyrë. Ai e ka përshkruar të pandehurin duke e nxjerrë revolen. Ai ka thënë se ai e ka tërhequr armën e tij. Atij nuk i kujtohet nëse ai ka mundur të nxjerrë armën e tij para se i pandehuri të ketë shkrepur i pari. Ai ka thënë se Sadik Musaj nuk kishte armë në dorën e tij. Ai ka thënë se ai ka qëlluar në ajër.

Megjithatë, në deklaratën që ai kishte dhënë në polici më 31 janar 2005, e kishte përshkruar të pandehurin duke e rrëmbyer xhakëtën e Sadik Musajt dhe të ketë gjuajtur dy apo tri herë. Ai nuk e ka përmendur të ketë dëgjuar Sadik Musajn të i thotë ndonjë gjë të pandehurit. Ai nuk e ka përmendur që Sadik Musaj gjoja se e ka qëlluar me shuplakë të pandehurin. Në të vërtetë, nga deklaratat e mëhershme duket se ai është kthyer vetëm kur ka dëgjuar të shtënë. Kjo e vë në kontradiktë dëshminë që ai kishte dhënë para kësaj gjykate.

Në deklaratën e tij në polici më 1 shkurt 2005 ai ka thënë se i pandehuri kishte ecur pranë tij dhe pastaj ai ka dëgjuar të

shtënat. Ai ka thënë se ai është kthyer dhe ka parë të pandehurin me armë në dorën e tij. Ai nuk e ka përmendur që të ketë dëgjuar Sadik Musajn të i thoshte ndonjë gjë të pandehurit. Sërish, ai nuk ka përmendur asnjë gjë që Sadik Musaj të ketë sulmuar të pandehurin. Në paraqitjen e asaj deklaratë duket se ai është kthyer vetëm pasi ka dëgjuar të shtënat.

Në deklaratën e tij në polici më 3 shkurt 2005 ai ka përshtuar të pandehurin duke ecur pranë tij. Ai ka thënë se ai u kthye dhe ka parë të pandehurin anash Sadik Musajt. Ai ka thënë se përafërsisht 3 metra ishte larg tyre. Kjo është e përputhshme me dëshminë që i pandehuri kishte dhënë para kësaj gjykate. Ai ka thënë në dorën e djathtë të të pandehurit e ka parë duke mbajtur një pistoletë në lartësinë me supin e tij dhe ishte e drejtuar në pjesën e pasme të supit të majtë të Sadikut. Tyta e pistoletës pothuajse prekte supin e Sadik Musajt. Ai ka thënë se i pandehuri ka shtënë. Ai ka thënë se Sadik Musaj menjëherë i është afruar të pandehurit dhe ata ishin përballë njëri tjetrit. Ai ka thënë se Sadik Musaj filloi të përkulej poshtë dhe ende me fytyrë nga i pandehuri. Ai ka thënë se i pandehuri ka shtënë për herë të dytë në barkun e Sadik Musajt. Ai ka thënë se Sadik Musaj ka rënë në tokë kurse ai e ka tërhequr armën e tij. Ai ka thënë se pastaj i pandehuri ka shtënë në drejtimin e tij. Ai ka thënë se Sadik Musaj nuk kishte armë në dorën e tij. Sërish, ai nuk e ka përmendur në deklaratat e tij të mëparshme të ketë parë Sadik Musajn duke e sulmuar të pandehurin. Ai nuk e ka përmendur të ketë dëgjuar Sadik Musajn të i ketë thënë ndonjë gjë të pandehurit. Kjo e ka vënë në kundërtënie dëshminë që ai e kishte dhënë para kësaj gjykate.

Kur ai ishte intervistuar nga policia më 12 shkurt 2005 ka thënë se i pandehuri ecte pranë tij. Pastaj ai ka dëgjuar një të shtënë. Ai ka thënë se ata dy nuk kanë pasur asnjë bisedë në mes veti. Edhe kjo ka vënë në kundërtënie disa aspekte të rëndësishme dëshminë që ky dëshmitar ka dhënë para kësaj gjykate.

Kur më 8 Nëntor 2010 ai është marrë në pyetje nga prokurori, ai ka thënë se i pandehuri dhe Sadik Musaj ishin fjalosur. Kjo është mbështetur nga dëshmitarët e tjerë. Ai ka thënë se fjalosja ka zgjatur vetëm 2 ose 3 sekonda. Pastaj ai ka dëgjuar një të shtënë. Ai ka thënë se është kthyer dhe ka parë Sadik Musajn "gjysmë të shtrirë". Kjo dëshmi është mbështetur nga dëshmia e . Edhe një herë ai ka thënë se Sadik Musaj nuk kishte asgjë në duar.

Kur ai ishte marrë në pyetje nga polici më nëntor 2010 ai ka thënë se ai kishte shtënë 3 ose 4 herë. Policia kishin rimarr vetëm një gëzhojë të armës me kalibër 7.62 mm. Duke e ditur se aty kishte borë ka mundësi se gëzhojat tjera mund të kenë humbur aty.

Kur ai ka dëshmuar para kësaj gjykate, ka thënë se ai ka shtënë me armën e tij në ajër. Megjithatë, kjo ishte në kundërthënie me dëshminë e mjekësisë ligjore. Vetëm një gëzhojë e plumbit ishte gjetur në vendin e ngjarjes. Ekzaminimi i xhaketës që ai e mbante të veshur në kohën e incidentit ka zbuluar se ai ka shtënë me armë siç duket e ka fshehur nën xhaketën e tij. Plumbi ka kaluar përmes xhaketës së tij. Vështirë se ai do të ketë shtënë në ajër përmes xhaketës së tij. Një sqarim i mundshëm është se pa vend ka shtënë përmes xhaketës së tij meqë me nxitim ka tërhequr armën e tij - ndoshta për shkak të një niveli paniku dhe, natyrisht, jo diçka që do të pranonte me dëshirë.

Ai i ka thënë policisë se ai ishte deri në 2 metra larg prej Sadik Musajt kur ai ishte qëlluar. Në të vërtetë, në një version të deklaratës së të pandehurit, ka shtënë dy herë para se i pandehuri ka tërhequr armën e tij. Nëse kjo është e vërtetë dhe se ka shtënë në të pandehurin sepse ai është përleshur me Sadik Musajn, ai ishte mjaftë keq i qëlluar. Si një çështje me logjikë të thjeshtë, një gjë duket të jetë e pasaktë kur është shtënë përderisa ishte duke shtënë tashmë.

A ka shtënë në ajër sepse i pandehuri është përleshur me Sadik Musaj? Kjo do të ishte e palogjikshme sikur Sadik Musaj të ishte sulmuesi.

Disa lloje të fjalëve shihet qartë se janë shkëmbyer në mes të pandehurit dhe Sadik Musajt. Kjo është mbështetur nga dëshmitarët e tjerë. Megjithatë, para se ai të jepte dëshminë para kësaj gjykate, nuk ka përmend asnjëherë se Sadik Musaj e ka sulmuar të pandehurin.

vazhdimisht e ka mohuar se Sadik Musaj ka pasur armë në dorën e tij. Edhe me rastin kur gjykata ka pranuar dëshminë që e ka dhënë para kësaj gjykate se Sadik Musaj e ka fyer dhe i ka rënë shuplakë të pandehurit, kurse reagimi i të pandehurit ka qenë me nxjerrjen e armës dhe ka qëlluar në Sadik Musajn, ishte plotësisht e papërshtatshme.

Kur ai ka dëshmuar para kësaj gjykate, e ka përshkruar se si në ditën e ngjarjes ai e ndihmonte të

pandehurin të ndezte veturën e tij. I pandehuri ka shkuar në afërsi të dyqani për pjesë të veturave me qëllim që të merrte kabllot për ndezje të veturës. është ulur në karrigen e vozitësit në veturën e të pandehurit dhe ka pritur deri sa ai është kthyer.

Ai ka dëshmuar se e ka parë të pandehurin duke ecur në drejtim të tij. Ai ka thënë se e ka dëgjuar dikë duke bërëtitur "ndal, ndal". Ai ka thënë se nuk e ka parë kush gjuante. Ai ka thënë se e ka pa Sadik Musajn duke shkuar mbrapa të pandehurit dhe mbrapa tij. Kjo e ka vënë në kundërthënie dëshminë e të pandehurit.

Ka genë argumenti i të pandehurit se është përplasur mbi të dhe deri sa ai ishte kthyer me fytyrë, ai ishte rrëmbyer nga Sadik Musaj. Kjo është në kundërshtim me dëshminë e . Së pari, ka dëshmuar se e ka parë të pandehurin duke ecur në drejtim të tij dhe dikë duke bërëtitur "ndal, ndal". Ishte rasti i të pandehurit kur ai ishte duke ecur në drejtim të - dhe kështu larg - kur është përplasur "mjaft fort" në të pak para se të rrëmbehej nga Sadik Musaj. E dyta, duke e thënë këtë si rast të pandehurit është përplasur, është e pamundur që nuk e ka parë atë. E treta, duke e parë se nuk ka asnjë dyshim ishte duke ecur para Sadik Musajt dhe pastaj si një çështje e një logjike të thjeshtë, nëse i pandehuri është kthyer me fytyrë kah pasi që ai është përplasur mbi të. do të ishte para Sadik Musajt dhe jo "prapa" Musajt, ashtu si ka dëshmuar .

e ka përshkruar Sadik Musajn duke e mbajtur rrëmbyeshëm të pandehurin dhe duke e kthyer atë me fytyrë nga ai. Ai nuk ka përmendur që Sadik Musaj të ketë sulmuar të pandehurin. Ai ka thënë se t'i ketë parë Sadik Musajn dhe duke i vënë duart në rrip. Ai ka menduar se po i marrin armët. Megjithatë, ai ka thënë se nuk ka parë armë në dorën e Sadik Musajt. Ai nuk e dinte kush ka shtënë me armë fillimisht.

Në disa aspekte materiale dëshminë që kishte dhënë para kësaj gjykata ka vënë në kundërthënie dëshmitë e tij të mëparshme.

Kur ai ishte intervistuar nga policia më 31 Janar 2005 ai nuk ka përmendur se ka parë ndonjë zënkë në mes të pandehurit dhe Sadik Musajt. Ai nuk ka përmendur që Sadik Musaj ka provuar të marrë armën. Faktikisht, në bazë të deklaratës së tij të më hershme,

vëmendja e tij nuk ishte e tërhequr ndaj të pandehurit deri pas dëgjimit të të shtënave.

Kur ai është marr në pyetje nga Policia me 1-2 Shkurt 2005, ai kishte thënë se nuk kishte parë ndonjë gjë. Prapë, ai nuk iu referua ndonjë grindjeje të supozuar në mes të pandehurit dhe Sadik Musajt. Në bazë të asaj deklaratë, duket se ishin të shtënat ato që ia tërhoqën vëmendjen e tij.

Dëshmia që ai e kishte dhënë tek Prokurori me 11 Nëntor 2010 ishte në shumicën e pikave të rëndësishme në përputhje me dëshminë që ai e dha në këtë Gjykatë.

I pandehuri ishte arrestuar me 21 Tetor 2010. Nuk është vetëm thjeshtë rastësi se dëshmia e tij tek Prokurori për afërsisht pas tri javëve ishte, në disa pika të rëndësishme, rrënjësisht e ndryshme nga dëshmia e tij e më hershme. Dëshmia e tij tek Prokurori në Nëntor 2010 dhe dëshmia e tij në këtë Gjykatë ishte haptazi e sajuar për ta ndihmuar të pandehurin.

Sidoqoftë, ishte i qëndrueshëm gjatë tërë dëshmisë së tij kur ai deklaroi se ai nuk kishte parë ndonjë armë në duart e Sadik Musajt.

nuk kishte dhënë më parë deklaratë në polici apo tek Prokurori në lidhje me faktet e çështjes. Ai ka përshkruar të këtë parë dy persona "duke u rrahur". Ai tha se një person i tretë ai filloi të shtinte. Ai tha se ai nuk e kishte parë asnjërin prej dy burrave të tjerë të cilët po rriheshin me një armë. Më vonë ai pa gjak në tokë mirëpo asgjë më shumë. Sipas dëshmisë së tij ishte ai që shtiu i pari. Ai nuk ka parë ndonjë armë në dorën e të pandehurit. Ai ka dëgjuar më pastaj të shtëna mirëpo nuk ka parë se kush kishte shtirë. Nëse faktikisht kishte qenë dëshmitar i ngjarjes në këtë rast është për çudi se si ai nuk ka parë armën në duart e të pandehurit. Në esencë, dëshmia e tij ishte thjeshtë se shtiu i pari.

nuk kishte dhënë më parë deklaratë në Polici apo tek Prokurori në lidhje me faktet e çështjes. Ai tha se ka parë dy persona duke ecur në drejtim të pandehurit. ndodhej për afërsisht 20-30 larg prej tyre.

e përshkroi të pandehurin duke ecur pranë kur Sadik Musaj e kapi të pandehurin për teshat e tij. Ai po ashtu nuk iu referua se t të këtë kërcyer mbi të pandehurin ashtu siç pretendoi i pandehuri. Nëse më të vërtetë do të kishte kërcyer "mjaftë rëndë" mbi të pandehurin është e pa

besueshme se nuk e ka parë këtë. Ai nuk e përmendi Sadik Musajn duke e sulmuar të pandehurin. Ai tha se ishte i pari që shtiu. Ai tha se po ashtu i pandehuri dhe Sadik Musaj kishin armë. Ai tha se këto armë ai i pa "më vonë". Ai dëgjoi të shtëna por nuk e pa se kush gjuajti. Dëshmia e tij binte në kundërshtim me dëshmitarët e tjerë dhe ishte qartazi e sajuar për ta ndihmuar të pandehurin.

e përshkroi se si, pasi që ata u ndriçuan nga makina ai e pa Sadik Musajn të shtrirë më fytyrë për toke në rrugë. Ai tha se ai ishte ngritur prej rrugës në të njëjtën pozitë, më fytyrë poshtë. Ai tha se kur po ngrihej lartë Sadik Musajn, ai i dëgjoi zhurmën e pjesëve të metalit që po binin në tokë. Ai e pa armën e Sadik Musajt në tokë. Ai e përshkroi se arma ra prej "mesit" të trupit të tij.

Kur ai u morë në pyetje nga Prokurori me 12 nëntor 2010, ai tha se diçka tha prej "rripit" të viktimës. Sidoqoftë, duke e ditur se viktima ishte ngritur prej tokës akoma më fytyrë të kthyer poshtë, nuk ka gjasa që ai ta këtë parë armën nën rripin e viktimës. Ky duket të ketë qenë thjesht një supozim. Ai nuk kishte dyshim se arma ra prej mesit të trupit të viktimës, kur viktima po ngritje prej tokës.

ka dëshmuar se e ka parë Sadik Musajn të shtrirë në tokë afër makinës së tyre. Ai i përshkroi dy ose tre persona duke e ngritur Sadik Musajn lartë prej tokës dhe duke e bartur atë për në makinën e tyre. Përderisa po e ngrinin Musajn ai dëgjoi, atë që e përshkroi si "peshimin" e armës që bie në tokë. Ai tha se e pa armën në tokë.

Kur ai është marr në pyetje nga Prokurori në nëntor 2010, ai e përshkroi se si kur Sadik Musaj po ngrihej lart prej tokës, dikush tha " atij i ra pistoleta". Ai e parë armën qartë ngase ai e përshkroi atë të ketë qenë e "ngjyrës së zezë".

, përshkroi se si ishte Sadik Musaj i shtrirë në tokë me fytyrë të kthyer poshtë. Ai ishte bartur në makinën e tyre në të njëjtën pozitë më fytyrë poshtë.

Më me rendësi, ai dëshmoi se kur Sadik Musaj po ngrihej lartë prej tokës dhe po e bartej në makinën e tyre, krahët e Musajt ishin të varura lirisht dhe se ai nuk ishte duke mbajtur ndonjë armë dore.

Në deklaratën e dhënë me 31 janar 2005 ai tha se kur ata po e bartnin drejt makinës së tyre ai e pa atë që ai e përshkroi si pistoletë të zezë që po binte prej trupit të Sadik Musajt.

Kur ai dëshmoi tek Prokurori më 25 nëntor 2010, ai e mohoi të ketë parë ndonjë rënie të pistoletës prej trupit të Sadik Musajt. Ai tha se kishte dëgjuar se një armë kishte rënë prej trupit të tij.

Kur ai dëshmoi, \_\_\_\_\_ ju kujtua se ka kaluar pranë tre burrave që siç duket ishin duke u fjalosur. Ai përshkroi se kishte dëgjuar një të shtënë arme. Ai u kthye prapë dhe pa njërin prej burrave të shtrirë në tokë. Ai tha të mos ketë parë ndonjë armë. Ata dy burrat e tjerë kishin ikur. Sidoqoftë, kujtesa e tij për ngjarjet e asaj dite të rastit ishte mjegulluar.

\_\_\_\_\_ dha deklaratë në Polici me 31 janar 2005 vetëm pas pak orëve të incidentit. Duke e ditur se kur ai ka dëshmuar në këtë Gjykatë mbajta mend e ngjarjeve ishte e dobët, Gjykata vendosi ta pranoj si më të besueshme versionin e ngjarjeve ashtu siç janë regjistruar në deklaratën e tij të dhënë në Polici në datën e rastit.

Në deklaratën e tij \_\_\_\_\_ përshkroi të ketë parë tre burra siç dukej duke biseduar në rrugë afër Hotel Park. Kjo ishte në kundërshtim me dëshminë e të pandehurit. Në vend se \_\_\_\_\_ të kërcente mbi të pandehurin dhe pastaj kapja menjëherë e tij nga Sadik Musaj ashtu siç pretendonte i pandehuri, \_\_\_\_\_ dëshmoi se grupi ishin duke u fjalosur. Është e qartë se ai në fillim nuk kishte parë kacafytje. Në të vërtetë, \_\_\_\_\_ kishte menduar se ata ishin shokë.

\_\_\_\_\_ dëshmoi se ai kaloi duke ecur pranë grupit. Pastaj ai dëgjoi një të shtënë arme. Ai u kthye dhe e pa njërin prej burrave duke rënë në tokë. Një person i dytë ishte duke e mbajtur një armë. \_\_\_\_\_ deklaroi " ...ky personi me pistoletë shtiu në personin që ishte gjallë, edhe tri herë". Ky deklaram ishte përforcuar me një shtojcë në të cilën \_\_\_\_\_ tha " ... personi i armatosur shtiu edhe tri here të tjera në personin që ishte duke rënë" . Ai nuk e përmendi të pandehurin, të ketë pasur armë në dorë.

Në deklaratën e tij në Polici me 31 Janar 2005, \_\_\_\_\_ e përshkroi se si kur po e vendosnin Sadik Musajn në një makinë, një armë ra prej trupit të tij.

ishte marr në pyetje nga Prokurori me 18 Nëntor 2010, askund nuk është përmendur ta ketë parë të pandehurin të shtinte ndaj Sadik Musaj. Ai i tha Prokurorit se kur viktimja po ngrihej prej tokës dhe kur ata po e vendosnin në makinë një armë ra prej viktimës. Ai mendoi se arma kishte qenë në brezin e viktimës. Është e qartë se ky ishte një supozim. Ai e mori armën dhe më vonë ja dorëzoi atë Policisë.

Gjykata ka gjetur se është dëshmitar i besueshëm. Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate, kujtimet e ngjarjeve të asaj dite të rastit ishin, relativisht, të megjulluara. Është e qartë se ai po mendohej ta epte me të mirën prej tij për ta ndihmuar Gjykatën, mirëpo kujtesa e tij për ngjarjet ishte dëmtuar në masë të theksuar nga kujtesa e dobët dhe kalimi i kohës qysh prej ngjarjes për të cilën ai ishte thirrur që të dëshmoj. Gjykata e ka konsideruar si më të besueshme deklaratën e Berishës të dhënë në Polici me 31 janar 2010.

I pandehuri dëshmoi se Sadik Musaj kishte një armë në dorë kur ata po kacafyteshin. Kjo dëshmi u mbështet nga Sidogoftë, Gjykata nuk e pranoi këtë dëshmi. Asnjëri prej dëshmitarëve të tjerë nuk e pa Sadik Musaj në dorë. Asnjë dëshmi nuk është vënë para kësaj Gjykate që Sadik Musaj shtiu një plumb të vetëm. Kjo është për tu befasuar duke pas parasysh kacafytjen ashtu siç i pandehuri e përshkroi. Në të vërtetë, vetëm atëherë kur Sadik Musajn ata po e ngrinin lartë prej tokës arma i ra prej trupit të tij.

Nëse Sadik Musaj ka pasur një armë në dorë përderisa ai ishte duke u rrahur me të pandehurin, është për tu befasuar se si arma tij nuk është gjetur në tokë afër apo nën trupin e tij. dëshmoi se kur po e bartnin Sadik Musajn për në makinë duart e tij po i rrinin lirshëm dhe se ai nuk kishte parë armë. Disa dëshmitar të Prokurorisë dëshmuan se kur po e bartnin Sadik Musajn tek makina atëherë i ra arma prej trupit. Shpjegimi më i mundshëm është se arma ishte në brezin e tij ose për ndryshe ajo ka dal prej trupit të Sadik Musajt kur ai po ngrihej lartë prej toke.

I pandehuri e ka mohuar ta ketë njohur Sadik Musaj. Ai tha të ja ketë dëgjuar emrin mirëpo kurrë nuk e kishte takuar atë dhe nuk e njihte për nga pamja. Disa dëshmitar dëshmuan se ata e kanë dëgjuar të pandehurin duke u fjalosur me Sadik Musaj. Kjo mbështet argumentin e Prokurorisë se ata e njohnin njëri tjetrin.

I pandehuri e pranoi se ai ka mbajtur një armë dore e cila siç tha ai ishte për ta mbrojtur pronën e tij. I pandehuri kishte një auto larje. Ai e mohoi ta ketë bartur atë për mbrojtje personale.

Janë interesante komentet që i kanë bërë dhe kur mësuan se Sadik Musaj ishte qëlluar.

Kur u intervistua nga policia më 25 Shkurt 2005 tha

"...nga disa kalimtarë ne mësuan se Sadik Musaj ishte vrarë nga një person i quajtur Atdhe. Kështu që ishim kureshtar të dinim se mos ishte vëllai ynë Atdheu."

Kur policia e intervistoi më 26 shkurt 2005, tha se kishte dëgjuar të përmendej emri Atdhe. Ai tha

"Kur dëgjova për këtë unë u brengosa për vëllain tim"

Përsëri, ky fakt mbështet argumentin e prokurorisë se i pandehuri njihte Sadik Musajn.

Prokuroria paraqiti në prova Vendimin e Gjykatës së Qarkut të Pejës në rastin numër CC 190/02 të datës 17 dhjetor 2002. Njëri nga të pandehurit në atë rast ka qenë . Ai qe dënuar për pjesën e tij në mbajtjen e paligjshme dhe vdekjen pasuese në vitin 1999 të, ndër tjerë, Sinan Musajt. Pasi u shpall fajtor për atë vepër u dënua me tri vite burgim.

Nuk ka pasur dyshim se është daja i të pandehurit dhe Sinan Musaj ka qenë vëllai i Sadik Musajt

Sadik Musaj dëshmoi për prokurorinë në gjykimin e

Në deklaratën e tij policisë tha se gjatë gjykimit Sadik Musaj i kishte kërcënuar të pandehurit duke thënë "Do të iu ha kokat". Ky kërcënim mund t'i ketë dhënë mbështetje argumentit të mbrojtjes se i pandehuri ka vepruar në vetëmbrojtje. Megjithatë, i pandehuri tha se asnjëherë nuk e kishte takuar Sadik Musajn dhe nuk e njihte si fytyrë.

I pandehuri gënjeu kur tha se ishte përplasur në të. Asnjëri nga dëshmitarët nuk e vërtetoi këtë fakt. I pandehuri gënjeu kur tha se Sadik Musaj e kishte kapur menjëherë. Dëshmitarët e përshkruan të pandehurin duke u

fjalosur me Sadik Musajn. I pandehuri gënjeu kur tha se Sadik Musaj nxori armë e tij të dorës. Vetëm dëshmoi se kishte parë një armë dore në dorën e Sadik Musajt. Ajo dëshmi u kundërshtua nga dëshmitarët tjerë. Në fakt, disa dëshmitarë dëshmuan se kanë parë një armë dore të bie nga trupi i Sadik Musajt përderisa po bartej në veturë. dëshmoi se ai nuk kishte parë një armë dore në dorën e Sadik Musajt përderisa ai po ngrihej nga vendi. I pandehuri gënjeu kur tha se kishte shtënë i pari. Ai dha dëshmi kundërthënëse rreth të shtënës së parë dhe të dytë për të cilat tha se ishin shtënë nga . Nëse do të kishte marrë në shënjestër të pandehurin, do të ishte e papërfytyrueshme që ai ta huq shënjestrën e tij nga një distancë e tillë e shkurtë dhe jo një herë por dy herë. Nëse ka shtënë lart në ajër atëherë pyetja është pse nëse Sadik Musaj ka qenë sulmuesi. Duke marrë në konsideratë të gjitha provat në këtë rast, gjykata gjen se i pandehuri nuk ka vepruar në vetëmbrojtje të domosdoshme.

I pandehuri mohoi se e njihte Sadik Musajn. Disa dëshmitarë dëshmuan se kanë dëgjuar të pandehurin duke u fjalosur me Sadik Musajn në ditën e ngjarjes. Kjo gjë mbështet argumentin e prokurorisë se ata njihnin njëri tjetrin.

Gjykata është bindur që i pandehuri njihte Sadik Musajn. Është e qartë nga fakti se janë fjalosur në ditën e ngjarjes se ka pasur armiqësi ndërmjet tyre. Asnjë provë nuk është paraqitur para gjykatës se vrasja ka qenë rezultat i asaj armiqësie apo hakmarrje për dënimin të mëparshëm të t. Ky ka mundur të jetë motivimi. Megjithatë, gjykata nuk është e kënaqur me nivelin e kërkuar të provës se ky, në fakt, ka qenë motivimi. Për këtë arsye, gjykata ka përjashtuar dënimin e të pandehurit sipas nenit 147 (9).

Gjykata po ashtu ka përjashtuar nenin 147 (4) dhe (5).

Sipas Nenit 147 (4) një i pandehur mund të dënohet për vrasje të rëndë nëse ai/ajo privon nga jeta një person tjetër dhe në këtë mënyrë qëllimisht rrezikon jetën e një apo më shumë personave. I pandehuri ka shtënë katër herë në një rrugë përplot njerëz. Dy plumba goditën lokalit "Te Taka". Mirëpo, Kodi thotë se i pandehuri duhet të veprojë "qëllimisht" - jo në mënyrë të shkujdesur.

Sipas nenit 147 (5) një i pandehur mund të dënohet për vrasje të rëndë nëse ai/ajo privon nga jeta një person tjetër duke vepruar dhunshëm dhe pamëshirshëm. Gjykata është e bindur se i

pandehuri ka vepruar me dhunë. Gjykata nuk është e bindur se i pandehuri ka vepruar pamëshirshëm.

Gjykata gjen se më 31 janar 2005 rreth orës 11.25 në rrugën kryesore Pejë-Deçan, në rrugën TMK në Pejë, afër hotelit Park, duke përdorur një armë dore "Browning M - 1911" me kalibër 9 x 19mm, me numër serik 200819, qëllloi nga një distancë e afërt Sadik Musajn i cili pësoi një plagë nga e shtëna në supin e majtë dhe një plagë në anën e majtë të abdomenit me një plagë dalëse në anën e djathtë të pjesës së përparme të abdomenit të tij të poshtëm si rezultat i të cilave i lartcekuri Sadik Musaj vdiq më datën 01 shkurt 2005 në Kampin Bondsteel në Kosovë. Certifikata e vdekjes shënon se shkak i vdekjes ka qenë Shoku Hemorragjik i shkakuar nga plagët në abdomen dhe qafë të shkaktuara nga të shtënat.

Ka qenë një takim i rastësishëm ndërmjet të pandehurit dhe Sadik Musajt më 31 janar 2005, gjatë të cili pasoi një fjalosje mes tyre. Ndonëse Sadik Musaj në mënyrë të paligjshme kishte në posedim një armë dore dhe granatë dore, Gjykata gjen se i pandehuri nuk ka vepruar në vetëmbrojtje të domosdoshme kur qëllloi Sadik Musajn.

I pandehuri ka shtënë së paku katër plumba nga arma e tij. Dy nga këta plumba janë shtënë nga afërsia dhe qëlluan Sadik Musajn. Dy plumba qëlluan lokalit "Te Taka".

Prandaj, i pandehuri ka kryer veprën penale të Vrasjes sipas nenit 146 të Kodit Penal të Kosovës.

#### **D. Përcaktimi i dënimit**

Kur shqipton sanksionimin penal, gjykata duhet t'i konsiderojë qëllimet e përgjithshme të dënimit, përfshirë përmbajtjen, parandalimin, dhe mbrojtjen e shoqërisë.

Në ditën e ngjarjes, i pandehuri ka qenë në posedim të paligjshëm të një arme dore të mbushur "Browning M - 1911" me kalibër 9 x 19mm dhe numër serik 200819 në një vend publik të cilën e ka përdorur për ta vrarë Sadik Musajn. I pandehuri nuk shfaqte keqardhje për veprën penale. Ai gënjeu kur tha se kishte vepruar në vetëmbrojtje. Gjykata i ka marrë parasysh këta faktorë si karakteristika rënduese gjatë vendosjes së shkallës së dënimit.

Sa i përket rrethanave lehtësuese, duhet të merret parasysh se të dhënat nga regjistri penal tregojnë se i pandehuri nuk kishte qenë i dënuar më parë dhe se sjellja e tij gjatë gjykimit ka qenë shembullore.

Dënimi, duke marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese, do të jetë pesëmbëdhjetë (15) vite burgim.

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në dënim.

#### **E. Shpenzimet**


Sipas nenit 102 paragrafi (1) lidhur me nenin 99 paragrafi (1) dhe (2) nën paragrafët (3), (4) dhe (6) të KPPK-së, i pandehuri do t'i paguajë shpenzimet e kësaj procedure penale në shumën prej 800 (tetëqind) Euro dhe shumën e paraparë në vlerë prej 100 (njëqind) Euro.

#### **F. Kërkesa për dëmshpërblim**

Pala e dëmtuar nuk ka qenë e pranishme në gjykim dhe nuk ka qenë e përfaqësuar. Sipas nenit 108 paragrafi 1 të KPPK-së, pala e dëmtuar mund të ushtrojë një kërkesë pasurorë kundër të pandehurit.

Nga arsyet e paraqitura këtu ne japim këtë Aktgjykim.

Data 03 qershor 2011.



---

Gjyqtari Gunnar Oyhaugen

---

Gjyqtari Sali Berisha



---

Svetoslava Savova  
Procesmbajtëse

**KESHILLA JURIDIKE:** Sipas nenit 398 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykit. Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar nëpërmjet Gjykatës së Qarkut të Pejës te Gjykata Supreme e Kosovës.